Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 02-949
Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 07.10.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Akreditohet **Qendra për Aftësim Profesional (QAP)** në Gjilan, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, nga data 07.10.2026 deri më 06.10.2028, për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimit të aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1. **"Zdrukthëtar"**, Niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

Institucioni mund të zbatojë procesin e Njohjes së Mësimit Paraprak në kuadër të këtij kualifikimi, në përputhje me politikat, procedurat dhe kërkesat e përcaktuara për NjMP-në, si dhe me kapacitetet institucionale, profesionale dhe materiale të verifikuara gjatë procesit të akreditimit. Vlerësimi dhe vendimmarrja për kandidatët duhet të realizohen në mënyrë individuale dhe të dokumentuar për secilin kandidat.

2. QAP Gjilan obligohet që gjatë periudhës së akreditimit t'i përmbushë rekomandimet e ekipit të ekspertëve, në veçanti fuqizimin e kapaciteteve njerëzore për zbatimin e NjMP-së, sigurimin e së paku një vlerësuesi të brendshëm, sigurimin e ndarjes së qartë të roleve dhe shmangien e konfliktit të interesit, si dhe adresimin e kërkesave të tjera të evidentuara në raportin e vlerësimit. Institucioni obligohet të dokumentojë përmbushjen e tyre dhe t'i nënshtrohet monitorimit pas akreditimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së **Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Gjilan** për akreditim për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimit "Zdrukthëtar", Niveli IV sipas KKK-së, si dhe rekomandimit të ekipit të ekspertëve të dala nga procesi i vlerësimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi vlerësues ka shqyrtuar dokumentacionin e aplikimit të QAP Gjilan më datë 28.03.2026 dhe ka realizuar vizitën vlerësuese në institucion më datë 08.04.2026. Pas shqyrtimit fillestar dhe vizitës në institucion, ekipit vlerësues i është dorëzuar dokumentacion dhe dëshmi plotësuese lidhur me strukturën, personelin, kapacitetet institucionale dhe financiare, sigurimin e cilësisë, pajisjet dhe materialet, strukturën modulare, instrumentet e vlerësimit, portofolion dhe organizimin e procesit të NjMP-së. Dokumentacioni shtesë është dorëzuar nga QAP Gjilan më datë 31.07.2026 dhe është shqyrtuar në kuadër të vlerësimit përfundimtar.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit rezulton se QAP Gjilan ka krijuar një bazë të konsiderueshme dokumentare, institucionale dhe procedurale për zbatimin e NjMP-së. Dokumentacioni përfshin informimin, identifikimin, udhëzimin dhe regjistrimin e kandidatëve, zhvillimin dhe verifikimin e portofolios, metodat dhe instrumentet e vlerësimit, vlerësimin praktik, certifikimin, trajtimin e ankesave, njohjen dhe transferimin e kredive, konfidencialitetin dhe menaxhimin e të dhënave personale, mundësitë e barabarta, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, verifikimin e brendshëm, monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.

Institucioni ka paraqitur dëshmi për strukturën organizative dhe personelin e angazhuar në procesin e NjMP-së, përfshirë koordinatorin, mentorin dhe vlerësuesit e jashtëm, si dhe dëshmi për përvojën profesionale dhe trajnimet përkatëse. Gjithashtu, janë paraqitur dëshmi për kapacitetet materiale, pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e vlerësimit praktik të kualifikimit "Zdrukthëtar", si dhe për hapësirat dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit.

Ekipi i ekspertëve ka vlerësuar pozitivisht bazën institucionale, profesionale, materiale dhe procedurale të krijuar nga QAP Gjilan dhe ka rekomanduar akreditimin e institucionit për zbatimin e NjMP-së në kuadër të kualifikimit **"Zdrukthëtar", Niveli IV sipas KKK-së**, me obligim që rekomandimet e evidentuara të adresohen gjatë periudhës së akreditimit dhe përmbushja e tyre të jetë objekt i monitorimit pas akreditimit.

Këshilli Drejtues i AKK-së, gjatë vendimmarrjes për akreditimin e QAP Gjilan, ka marrë parasysh dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, vizitën në institucion, dokumentacionin shtesë të dorëzuar, të gjeturat e ekipit të ekspertëve dhe rekomandimet përfundimtare të tyre.

Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues i AKK-së, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD-së së AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës për Aftësim Profesional (QAP) në Gjilan;
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD-së së AKK-së